



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 220, Datë 04.07.2023

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “NOVA SOLAR SYSTEM” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/9 prot., datë 03.07.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 MW”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 05.05.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 3358, fshati Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 06.05.2023 dhe 08.05.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 04.06.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1319/5 prot., datë 18.05.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., duke e njoftuar për fillimin e procedurës për licencim dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore me qëllim plotësimin e pjesës tjetër të dokumentacionit të konstatuar të munguar.
- Pas korrespondencës së zhvilluar mbi dokumentacionin e mbetur pa plotësuar, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e fundit plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. nr.1319/8 prot ., datë 29.06.2023.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në kuadër të këtij aplikimi, vlerësohet të zgjatet deri në 20 (njëzetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM ”sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 50 MW.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**